

UDHËZIM
Nr.36, datë 22.10.2008

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE MASTER I NIVELIT TË PARË, ME KOHË TË
PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN
AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit të miratuara për vitin akademik 2008- 2009”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Kandidatët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kriterëve të pranimi të përcaktuara nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të publikuara më parë.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimi dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë. Procesi të monitorohet nga administrata e rektoratit dhe e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimi të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë.

5. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të zhvillohet nga data 23.10.2008 deri në datën 27.10.2008, prej orës 8.⁰⁰ deri në orën 18.⁰⁰ pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore. Për regjistrim, aplikanti të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Certifikatë personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekësh.

6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të ngrihen komisione *ad-hoc*, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, në përputhje me kriteret e pranimi të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Komisionet *ad-hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, përcaktojnë mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara për të gjithë ata kandidatë që vijnë nga programe studimi të ngjashme, të ciklit të parë.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.⁰⁰ të datës 28.10.2008, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara me vendimin nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave.

9. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 29.10.2008 deri në datën 31.10.2008, prej orës 8.⁰⁰ deri në orën 18.⁰⁰ pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u

kthehen personave kundrejt kërkesës.

10. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 30.11.2008, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

11. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 23.10.2008, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar e elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

13. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, zëvendësministri për arsimin e lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja